



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit/Opština Orahovac/Municipality Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme



Odeljenje za Opštu Upravu

Data/Date:	19.12.2018	-III- Nr. i prot. 3336 Më 19-12-2018 Br. prot. RAHOVEC ORAHOVAC
Për/Za/To:	Kuvendi Komunal Rahovec	
Nga/Od/From	Komisioni për zgjedhjen e Kryetarëve dhe Këshillave të lagjeve urbane, fshatrave dhe vendbanimeve në Komunën e Rahovecit	
Tema/Subjekat/Subject	Raport mbi zgjedhjen e Kryetarëve dhe Këshillave të lagjeve urbane, fshatrave dhe vendbanimeve në Komunën e Rahovecit	

Në vazhdim po ju raportojmë për zgjedhjen e Kryetarëve dhe Këshillave të lagjeve urbane, fshatrave dhe vendbanimeve në Komunën e Rahovecit

Në bazë të nenit 11, nenit 12 pika 12, paragrafi 12.2 pika(c), nenit 34 paragrafi 4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, Udhëzimit të MAPL-së 2008/8 për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane si dhe nenit 5 të Statutit të Komunës, Kuvendi Komunal i Rahovecit më datë 28 gusht 2014 ka miratuar Rregulloren për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në tërë territorin e Komunës së Rahovecit.

Me anë të Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Rahovecit është rregulluar mënyra e organizimit dhe bashkëpunimit midis Komunës, fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, duke formuar kështu këshillat lokal si trupa mbështetës të organeve të Komunës dhe që ndikojnë në konsultime gjithëpërfshirëse të cilat promovojnë dhe zhvillojnë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes.

Në mbështetje të nenit 12, shkronja(d), neneve 17,34 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040(Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës-Nr.28/15 qershor2008), neneve 2,3,4 dhe 5 të Rregullores për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat.Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në territorin e Komunës së Rahovecit 01 Nr.3323 të datës: 28.08.2014, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur më datë 28.06.2018 merr këtë Vendim:

Vendim për emërimin e Komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për zgjedhjen e këshillave lokale në fshatra dhe lagje urbane në Komunën e Rahovecit.

Komisioni i emëruar nga Kuvendi Komunal Rahovec ka udhëhequr dhe koordinuar punën në terren për zgjedhjen e këshillave lokal.

Komisioni për zgjedhjen e këshillave lokal përbëhet nga gjithsej 7 anëtarë: 3 anëtarë nga Kuvendi i Komunës, 2 anëtar nga Ekzekutivi, 1 nga shoqëria civile dhe 1 përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagja urbane.

Kryesuesi i Komisionit është zgjedhur nga anëtarët e Komisionit.

Anëtarët e Komisionit për zgjedhjen e këshillave lokal në Komunën e Rahovecit janë:

1. Rexhep Oruqi- anëtar i Kuvendit të Komunës nga radhët e subjektit të PDK-së
2. Faton Ramadani anëtar i Kuvendit të Komunës nga radhët e subjektit - të LDK-së
3. Afrim Berisha – anëtar i Kuvendit të Komunës nga radhët e subjektit të AAK-së
4. Përparim Krasniqi- anëtar nga Ekzekutivi i Komunës
5. Saranda Sallteku- anëtare nga Ekzekutivi i Komunës
6. Adnan Rexha- anëtar nga Shoqëria Civile, SHL- Kosova
7. Përfaqësues të fshatrave, vendbanimeve ose lagjeve urbane.

Komisioni ka për detyrë të mbaj procesverbal për çdo tubim konform nenit 7 të Rregullores për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në territorin e Komunës së Rahovecit 01 Nr.3323 të datës 28.08.2014.

Procesmbajtëse në të gjitha takimet bashkë me Komisionin për zgjedhjen e këshillave lokal ishte:

1. Nora Boshnjaku- Procesmbajtëse

Ky Komision i emëruar nga Kuvendi Komunal Rahovec ka bërë caktimin e periudhës kohore të mbajtjes së tubimeve të qytetarëve për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokal dhe kryetarëve të këshillave lokal të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Nëpërmjet Zyres për informim Komisioni i emëruar nga Kuvendi Komunal Rahovec ka informuar qytetarët 15 ditë para mbajtjes së tubimit për zgjedhjen e këshillave lokal përmes mediave lokale, web-faqes zyrtare të Komunës me përmbajtje të datës, kohës dhe vendit të mbajtjes së tubimit të qytetarëve për zgjedhjen e këshillave lokal.

Takimet me qytetarë për zgjedhjen e këshillave lokal kanë filluar nga data: 16.11.2018 dhe kanë përfunduar më datë: 14.12.2018, janë mbajtur gjithsej 38 takime me qytetarë për zgjedhjen e këshillave lokal në gjithsej 33 fshatra të Komunës së Rahovecit, dhe në pesë lagje urbane të qytetit të Rahovecit.

Gjatë procesit zgjedhor është vërejtur një interesim i madh i banorëve të lokaliteteve të ndryshme sa i përket zgjedhjes së këshillave lokal dhe kryetarëve të këshillave.

Përfaqësimi gjinor në këshilla patjetër që është i domosdoshëm dhe për këtë arsye para fillimit të mbajtjes së takimeve me qytetarë zyra për barazi gjinore bashkë me drejtoreshën e administratës komunale në Rahovec dhe Kryesuesen e Grupit jo formal të grave kanë mbajtur takime të ndryshme me gra duke krijuar kështu një mundësi më shumë për vetëdijesimin e gruas për pjesëmarrje në këshilla lokal, ku mund të thuhet se sadopak është rritur pjesëmarrja e gruas në këshillat lokal .

Procesi gjatë gjithë kohës ka ecur mirë nuk ka pasur ndonjë parregullsi ose akçes, gjithçka ka vajtur në mënyrë të rregullt dhe konform rregullores.

Në vijim po paraqesim procesin e zgjedhjes së Kryetarëve dhe Këshillave të lagjeve urbane, fshatrave dhe vendbanimeve në Komunën e Rahovecit, deri më datën 01.12.2018 .

FSHATI XËRXE

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Xërxe, filloi në orën 18:00 më datë 16.11.2018 ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokal, të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, procesin e ndihmoi edhe Kryesuesi i KK- Rahovec z.Afrim Dina.

Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit hapi takimin dhe informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit

Me propozimin e qytetarëve të fshatit Xërxe dhe aprovimin e tyre këshilli i fshatit Xërxe do të ketë gjithsej 11 anëtarë në përbërje me arsyetimin se janë një numër i madh i banorëve të cilët banojnë në këtë fshat dhe përfaqësimi duhet të bëhet nga të gjitha lagjet, një përfaqësues nga komuniteti i biznesit si dhe dy përfaqësuese të gjinisë femërore duke përmbushur kështu edhe përbërjen gjinore në këshillin e fshatit.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Xërxe ishin si në vijim:

1. Murat Kryeziu
2. Behar Thaqi
3. Kapllan Gashi
4. Mazllum Gashi
5. Sherif Bytyqi
6. Qerim Gashi
7. Qëndresa Kryeziu
8. Lulzim Kryeziu
9. Armend Kryeziu

10. Jeton Kryeziu

11. Jehona Kryeziu.

Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e Këshillit të fshatit Xërxë, për të vazhduar me propozimet për Kryetar të Këshillit të fshatit Xërxë.

Të propozuarit për kryetar këshilli të fshatit Xërxë ishin si në vijim:

1. Murat Kryeziu

2. Behar Thaqi

Procesi i votimit ka ecur me rregull dhe sipas procedurave, gjithsej votues ishin 165.

- Fletëvotime të vlefshme-165
- Murat Kryeziu mori gjithsej : 117 vota
- Behar Thaqi mori gjithsej: 48 vota.

Me 117 vota gjithsej Murat Kryeziu u zgjodh kryetar i këshillit të fshatit Xërxë, i cili me një fjalë rasti falënderoi të gjithë për besimin duke cituar se së bashku me këshillin do punojnë në të mirë të fshatit.

Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit konstatoi të mbyllur takimin me qytetarët e fshatit Xërxë.

FSHATI SOPNIQ

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Xërxë, filloi në orën 17:00 më datë 17.11.2018 ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokal, të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, me propozimin dhe aprovimin e tyre anëtar i komisionit nga fshati Sopniq u emërua z.Xhafer Gashi, procesin e ndihmoi edhe Kryesuesi i KK- Rahovec z.Afrim Dina.

Kryetari i deri tanishëm z.Mensur Gashi hapi takimin duke falënderuar të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre në këtë takim dhe apeloj që procesi të shkojë në mënyrë të rregullt duke e falënderuar edhe komisionin për punën e tyre.

Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Banorët e fshatit Sopniq me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit Sopniq të ketë në përbërje gjithsej 5 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Sopniq ishin si në vijim:

1. Mitat Gashi

2. Naim Gashi

3. Mensur Gashi
4. Fadil Gashi
5. Elhami Morina.
6. Ilir Thaqi
7. Arben Gashi

Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e Këshillit të fshatit Sopniq, për të vazhduar me propozimet për Kryetar të Këshillit të fshatit Sopniq.

Të propozuarit për kryetarin e këshillit të fshatit Sopniq ishin si në vijim:

z.Xhafer Gashi propozoi që z.Mensur Gashi kryetar aktual i këshillit të fshatit Sopniq të vazhdojë aktivitetin dhe angazhimin e tij karshi fshatit Sopniq ashtu siç ka bërë deri më tani.

- z.Mensur Gashi- i propozuar për kryetar këshilli

z.Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit e qiti në votim të hapur propozimin e z.Xhafer Gashi pasi që nuk kishte propozim tjetër nga qytetarët e fshatit Sopniq.

Me aklamacion z.Mensur Gashi u zgjodh edhe për një mandat kryetar i këshillit të fshatit Sopniq.

Të pranishëm ishin gjithsej: 37 qytetarë të fshatit Sopniq.

Në fund të takimit z.Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit konstatoi të mbyllur takimin me qytetarët e fshatit Sopniq dhe kryetarit të zgjedhur të këshillit të fshatit Sopniq i uroi suksese dhe mbarësi në vazhdim.

FSHATI FORTESË

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Fortesë filloi në orën 18:30 më datë 17.11.2018 ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokal, të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, me propozimin dhe aprovimin e tyre anëtar i komisionit nga fshati Fortesë u emërua z.Fatmir Kadiri , procesin e ndihmoi edhe Kryesuesi i KK- Rahovec z.Afrim Dina.

Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Banorët e fshatit Fortesë me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit Fortesë të ketë në përbërje gjithsej 7 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Fortesë ishin si në vijim:

1. Bejtullah Kelmendi
2. Skënder Fetoshi
3. Muharrem Zhuniqi]
4. Lulzim Gashi

5. Fatmir Kadiri.

Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e Këshillit të fshatit Fortesë , për të vazhduar me propozimet për Kryetar të Këshillit të fshatit Fortesë.

Të propozuarit për kryetarin e këshillit të fshatit Fortesë ishin si në vijim:

1. Besnik Popaj
2. Hilmi Popaj.

Pasi që ishin dy të propozuar z. Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit informoi të pranishmit për procedurat e votimit të fshehtë duke hapur kështu edhe procesin e votimit për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit.

Gjithsej votues: 100

Fletëvotime të vlefshme:100

Fletëvotime të pavlefshme:0

Besnik Popaj mori gjithsej: 53 vota

Hilmi Popaj mori gjithsej 47 vota.

Me 53 vota gjithsej z.Besnik Popaj u zgjodh kryetar i këshillit të fshatit Fortesë.

z.Rexhep Oruqi konstatoi të mbyllur takimin dhe kryetarit të ri të këshillit të fshatit Fortesë i uroi sukses në punën e tij.

FSHATI POTOQAN I ULËT

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Potoqan i Ulët filloi në orën 17:00 më datë 19.11.2018 ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokal, të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, me propozimin dhe aprovimin e tyre anëtar i komisionit nga fshati Potoqan i Ulët u emërua z.Samedin Zeka , procesin e ndihmoi edhe Kryesuesi i KK- Rahovec z.Afrim Dina.

Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Banorët e fshatit Potoqan i Ulët me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje gjithsej 7 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Potoqan i Ulët ishin si në vijim:

1. Arben Zeka
2. Gëzim Mustafa
3. Lulzim Ahmeti
4. Nadir Sulejmani

5. Burhan Hoti
6. Riza Hajredini
7. Ethem Tola.

Banorët e fshatit Potoqan i Ulët me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë këta 7 anëtarë në përbërje, duke vazhduar më pastaj me propozimet e tyre për kryetar këshilli të fshatit.

Të propozuarit për kryetarin e këshillit të fshatit Potoqan i ulët ishin si në vijim:

1. Gëzim Mustafa
2. Arben Zeka.

Pasi që ishin dy të propozuar z. Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit informoi të pranishmit për procedurat e votimit të fshehtë duke hapur kështu edhe procesin e votimit për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit.

Gjithsej votues: 83

Fletëvotime të vlefshme: 83

Fletëvotime të pavlefshme: 0

Gëzim Mustafa mori gjithsej: 44 vota

Arben Zeka mori gjithsej: 39 vota.

Me 44 vota gjithsej z. Gëzim Mustafa u zgjodh kryetar i këshillit të fshatit Potoqan i Ulët.

z. Rexhep Oruqi konstatoi të mbyllur takimin dhe kryetarit të ri të këshillit të fshatit Potoqan i ulët i uroi suksese dhe mbarësi në punë.

FSHATI POTOQAN I EPËRM

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Potoqan i Epërm filloi në orën 18:00 më datë 19.11.2018 ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokal, të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, me propozimin dhe aprovimin e tyre anëtar i komisionit nga fshati Potoqan i Ulët u emërua z. Hidaç Maliqi, procesin e ndihmoi edhe Kryesuesi i KK- Rahovec z. Afrim Dina.

Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Banorët e fshatit Potoqan i Epërm, me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje gjithsej 3 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Potoqan i Epërm ishin si në vijim:

1. Selim Bellaqa
2. Nazmi Bellaqa

3. Hilmi Ymeri.

Banorët e fshatit Potoqan i Epërm me aklamacion (votim të hapur) u pajtuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje këta tre anëtarë, duke vazhduar më pastaj me propozimet për kryetar këshilli të fshatit.

Të propozuarit për kryetarin e këshillit të fshatit Potoqan i Epërm ishin si në vijim:

Selim Maliqi propozoi : z.Selim Bellaqa

Pasi që nuk kishte propozime të tjera nga banorët e fshatit, z.Rexhep Oruqi e qiti në votim të hapur propozimin e z. Selim Maliqi.

Me aklamacion(votim të hapur) nga gjithsej 11 të pranishëm z.Selim Bellaqa u zgjodh kryetar i këshillit të fshatit Potoqan i Epërm.

z.Rexhep Oruqi konstatoi të mbyllur takimin dhe kryetarit të ri bashkë me këshillin ju uroi punë të palodhshme dhe shumë suksese e përfaqësim sa më dinjitoz në interes të banorëve të këtij lokaliteti.

FSHATI NUSHPAL

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Nushpal filloi në orën 19:00 më datë 19.11.2018 ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokal, të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, me propozimin dhe aprovimin e tyre anëtar i komisionit nga fshati Nushpal u emërua z.Fatmir Morina , procesin e ndihmoi edhe Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Banorët e fshatit Nushpal, me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje gjithsej 5 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Nushpal ishin si në vijim:

1. Besnik Kastrati
2. Lulzim Morina
3. Fatmir Morina
4. Faton Morina
5. Fadil Berisha.

Banorët e fshatit Nushpal, me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje këta 5 anëtarë.

Të propozuarit për kryetarin e këshillit të fshatit Nushpal ishin si në vijim:

Besnik Kastrati propozoi : z.Fatmir Morina

Pasi që nuk kishte propozime të tjera nga banorët e fshatit, z.Rexhep Oruqi e qiti në votim të hapur propozimin e z. Besnik Kastrati

Me aklamacion(votim të hapur) nga gjithsej 21 të pranishëm z.Fatmir Morina u zgjodh kryetar i këshillit të fshatit Nushpal

z.Rexhep Oruqi konstatoi të mbyllur takimin dhe kryetarit të ri bashkë me këshillin ju uroi punë të palodhshme dhe shumë suksese e përfaqësim sa më dinjitoz në interes të banorëve të këtij lokaliteti.

FSHATI DRENOC

Më datë: 20.11.2018 me fillim në orën 18:30 u mbajt takimi me banorët e këtij fshati për zgjedhjen e këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Drenoc.

Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, me propozimin dhe aprovimin e tyre anëtar i komisionit nga fshati Drenoc u emërua z.Gëzim Makshana.

Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Banorët e fshatit Drenoc , me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje gjithsej 7 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Drenoc ishin si në vijim:

1. Xhemajli Kastrati
2. Kajtaz Berisha
3. Besim Bajrami
4. Sherif Haxhiu
5. Hajrullah Zyberaj
6. Arsim Kastrati
7. Gëzim Makshana.

Banorët e fshatit Drenoc me aklamacion (votim të hapur) u pajtuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje këta shtatë anëtarë, duke vazhduar më pastaj me propozimet për kryetar këshilli të fshatit.

Të propozuarit për kryetar këshilli të fshatit Drenoc ishin si në vijim:

1. Xhemajli Kastrati
2. Kajtaz Berisha

Pasi që ishin dy të propozuar z. Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit informoi të pranishmit për procedurat e votimit të fshehtë duke hapur kështu edhe procesin e votimit për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit.

Gjithsej votues: 148

Fletëvotime të vlefshme:148

Fletëvotime të pavlefshme:0

Xhemajli Kastrati mori gjithsej: 83 vota

Kajta Berisha mori gjithsej: 65 vota.

Me 83 vota gjithsej z.Xhemajli Kastrati u zgjodh kryetar i këshillit të fshatit Drenoc.

z.Rexhep Oruqi konstatoi të mbyllur takimin dhe kryetarit të ri të këshillit të fshatit Drenoc i uroi suksese dhe mbarësi në punë.

FSHATI SENOC

Më datë: 21.11.2018 me fillim në orën 17:00 u mbajt takimi me banorët e këtij fshati për zgjedhjen e këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Senoc.

Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, me propozimin dhe aprovimin e tyre anëtar i komisionit nga fshati Drenoc u emërua z.Ramiz Krasniqi.

Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Banorët e fshatit Senoc, me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje gjithsej 7 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Senoc ishin si në vijim:

1. Daut Krasniqi
2. Adem Krasniqi
3. Elez Morina
4. Ramiz Krasniqi
5. Selman Krasniqi
6. Ali Morina
7. Musaj Berisha.

Banorët e fshatit Senoc me aklamacion (votim të hapur) u pajtuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje këta shtatë anëtarë, duke vazhduar më pastaj me propozimet për kryetar këshilli të fshatit.

Të propozuarit për kryetarin e këshillit të fshatit Senoc ishin si në vijim:

Avni Krasniqi propozoi : z.Daut Krasniqi

Pasi që nuk kishte propozime të tjera nga banorët e fshatit, z.Rexhep Oruqi e qiti në votim të hapur propozimin e z. Avni Krasniqi

Me aklamacion(votim të hapur) nga gjithsej 49 të pranishëm z.Daut Krasniqi u zgjodh kryetar i këshillit të fshatit Senoc.

z.Rexhep Oruqi konstatoi të mbyllur takimin dhe kryetarit të ri bashkë me këshillin ju uroi punë të palodhshme dhe shumë suksese e përfaqësim sa më dinjitoz në interes të banorëve të këtij lokaliteti.

FSHATI PASTASELLË

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Pastasellë filloi në orën 18:30 më datë 21.11.2018 ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokal, të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, me propozimin dhe aprovimin e tyre anëtar i komisionit nga fshati Nushpal u emërua z.Ibrahim Krasniqi.

Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Banorët e fshatit Pastasellë me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje gjithsej 3 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Pastasellë ishin si në vijim:

1. Jeton Krasniqi
2. Shemsedin Krasniqi
3. Asllan Krasniqi.

Banorët e fshatit Patasellë me aklamacion (votim të hapur) u pajtuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje këta tre anëtarë, duke vazhduar më pastaj me propozimet për kryetar këshilli të fshatit.

Të propozuarit për kryetarin e këshillit të fshatit Pastasellë ishin si në vijim:

Mehmet Krasniqi propozoi : z. Jeton Krasniqi

Pasi që nuk kishte propozime të tjera nga banorët e fshatit, z.Rexhep Oruqi e qiti në votim të hapur propozimin e z. Mehmet Krasniqi.

Me aklamacion(votim të hapur) z.Jeton Krasniqi u zgjodh kryetar i këshillit të fshatit Pastasellë.

z.Rexhep Oruqi konstatoi të mbyllur takimin dhe kryetarit të ri bashkë me këshillin ju uroi punë të palodhshme dhe shumë suksese e përfaqësim sa më dinjitoz në interes të banorëve të këtij lokaliteti.

FSHATI KOZNIK

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Pastasellë filloi në orën 17:00 më datë 22.11.2018 ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokal, të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, me propozimin dhe aprovimin e tyre anëtar i komisionit nga fshati Koznik u emërua z.Hasan Isakaj.

Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Banorët e fshatit Koznik me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje gjithsej 3 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Koznik ishin si në vijim:

1. Kamer Isakaj
2. Afrim Fejza
3. Hamëz Sallahu.

Banorët e fshatit Koznik me aklamacion (votim të hapur) u pajtuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje këta tre anëtarë, duke vazhduar më pastaj me propozimet për kryetar këshilli të fshatit.

Të propozuarit për kryetarin e këshillit të fshatit Koznik ishin si në vijim:

Afrim Fejza propozoi : z. Kamer Isakaj

Pasi që nuk kishte propozime të tjera nga banorët e fshatit, z.Rexhep Oruqi e qiti në votim të hapur propozimin e z. Afrim Fejza.

Me aklamacion(votim të hapur) z.Kamer Isakaj u zgjodh kryetar i këshillit të fshatit Koznik.

z.Rexhep Oruqi konstatoi të mbyllur takimin dhe kryetarit të ri bashkë me këshillin ju uroi punë të palodhshme dhe shumë suksese e përfaqësim sa më dinjitoz në interes të banorëve të këtij lokaliteti.

FSHATI POLLUZHË

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Pastasellë filloi në orën 19:00 më datë 22..11.2018 jo ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokal pasi që banorët ishin të informuar nga Kryetari aktual i fshatit në këtë mënyrë, të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, me propozimin dhe aprovimin e tyre anëtar i komisionit nga fshati Polluzhë u emërua z.Avdi Bajraktari.

Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Banorët e fshatit Polluzhë me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje gjithsej 7 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Polluzhë ishin si në vijim:

1. Isuf Hoti
2. Ukë Bajraktari
3. Gazmend Dulaj
4. Avdi Bajraktari
5. Ilir Morina
6. Bashkim Morina
7. Jonuz Hoti.

Banorët e fshatit Polluzhë me aklamacion (votim të hapur) u pajtuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje këta shtatë anëtarë, duke vazhduar më pastaj me propozimet për kryetar këshilli të fshatit.

Të propozuarit për kryetarin e këshillit të fshatit Polluzhë ishin si në vijim:

Milaim Hoti propozoi : z. Jonuz Hoti

Pasi që nuk kishte propozime të tjera nga banorët e fshatit, z.Rexhep Oruqi e qiti në votim të hapur propozimin e z. Milaim Hoti.

Me aklamacion(votim të hapur) z.Jonuz Hoti u zgjodh kryetar i këshillit të fshatit Polluzhë.

z.Rexhep Oruqi konstatoi të mbyllur takimin dhe kryetarit të ri bashkë me këshillin ju uroi punë të palodhshme dhe shumë suksese e përfaqësim sa më dinjitoz në interes të banorëve të këtij lokaliteti.

FSHATI ÇIFLLAK

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Çifllak filloi në orën 17:00 më datë 23.11.2018 ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokal edhe pse disa nga banorët thonin që nuk ishin të informuar mirë dhe në këtë mënyrë kryesuesi i komisionit e qiti në votim të hapur propozimin se a duhet të mbahet takimi për zgjedhjen e këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit, banorët me aklamacion u pajtuan që takimi të vazhdojë dhe të fillojë procesi ashtu siç duhet.

Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, me propozimin dhe aprovimin e tyre anëtar i komisionit nga fshati Çifllak u emërua z.Halit Sahiti.

Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Banorët e fshatit Çifllak me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje gjithsej 7 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Çifllak ishin si në vijim:

1. Sali Thaqi
2. Bashkim Gashi
3. Ramadan Limani
4. Qamil Kabashi
5. Sadri Krasniqi
6. Halit Sahitaj
7. Sadik Thaqi.

Banorët e fshatit Çifllak me aklamacion (votim të hapur) u pajtuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje këta shtatë anëtarë, duke vazhduar më pastaj me propozimet për kryetar këshilli të fshatit.

Të propozuarit për kryetarin e këshillit të fshatit Çifllak ishin si në vijim:

z.Skënder Krasniqi propozoi : z. Sali Thaqi

Pasi që nuk kishte propozime të tjera nga banorët e fshatit, z.Rexhep Oruqi e qiti në votim të hapur propozimin e z. Skënder Krasniqi.

Me aklamacion(votim të hapur) z. Sali Thaqi u zgjodh kryetar i këshillit të fshatit Çifllak.

z.Rexhep Oruqi konstatoi të mbyllur takimin dhe kryetarit të ri bashkë me këshillin ju uroi punë të palodhshme dhe shumë suksese.

FSHATI KRAMOVIK

Më datë: 23.11.2018 me fillim në orën 18:30 u mbajt takimi me banorët e këtij fshati për zgjedhjen e këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Kramovik.

Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, me propozimin dhe aprovimin e tyre anëtar i komisionit nga fshati Kramovik u emërua z.Nesret Berisha.

Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Banorët e fshatit Kramovik , me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë 7 anëtarë gjithmonë duke respektuar edhe përfshirjen e gjinisë femërore në këshill.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Kramovik ishin si në vijim:

1. Xhafer Berisha
2. Ramadan Thaqi
3. Binak Berisha
4. Murat Berisha
5. Ukë Krasniqi
6. Emine Kelmendi
7. Pashkë Morina.

Banorët e fshatit Kramovik me aklamacion (votim të hapur) u pajtuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje këta shtatë anëtarë, duke vazhduar më pastaj me propozimet për kryetar këshilli të fshatit.

Të propozuarit për kryetarin e këshillit të fshatit Kramovik ishin si në vijim:

1. Binak Berisha
2. Murat Berisha.

Pasi që ishin dy të propozuar z. Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit informoi të pranishmit për procedurat e votimit të fshehtë duke hapur kështu edhe procesin e votimit për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit.

Gjithsej votues: 83

Fletëvotime të vlefshme:83

Fletëvotime të pavlefshme:0

Binak Berisha mori gjithsej: 59 vota

Kajta Berisha mori gjithsej: 23 vota.

Me 59 vota gjithsej z.Binak Berisha u zgjodh kryetar i këshillit të fshatit Kramovik.

z.Rexhep Oruqi konstatoi të mbyllur takimin dhe kryetarit të ri të këshillit të fshatit Kramovik i uroi suksese dhe mbarësi në punë.

FSHATI GURI I KUQ

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Guri i Kuq filloi në orën 17:00 më datë 24.11.2018 ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokal, të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, me propozimin dhe aprovimin e tyre anëtar i komisionit nga fshati Guri i Kuq u emërua z.Bedri Beqiraj.

Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Banorët e fshatit Guri i Kuq , me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje gjithsej 7 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Guri i Kuq ishin si në vijim:

1. Dul Xhemaj
2. Qamil Brahaj
3. Faton Fetahaj
4. Përparim Zymeraj
5. Azem Sylejmani
6. Idriz Osmanaj
7. Haxhi Halilaj.

Banorët e fshatit Guri i Kuq me aklamacion (votim të hapur) u pajtuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje këta shtatë anëtarë, duke vazhduar më pastaj me propozimet për kryetar këshilli të fshatit.

Të propozuarit për kryetarin e këshillit të fshatit Guri i Kuq ishin si në vijim:

z.Bedri Beqiraj propozoi : z. Faton Fetahaj.

Pasi që nuk kishte propozime të tjera nga banorët e fshatit, z.Rexhep Oruqi e qiti në votim të hapur propozimin e z. Bedri Beqiraj.

Me aklamacion(votim të hapur) z.Faton Fetahaj u zgjodh kryetar i këshillit të fshatit Guri i Kuq.

z.Rexhep Oruqi konstatoi të mbyllur takimin dhe kryetarit të ri bashkë me këshillin ju uroi punë të palodhshme dhe shumë suksese e përfaqësim sa më dinjitoz në interes të banorëve të këtij lokaliteti.

FSHATI MRASOR

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Mrasor filloi në orën 19:00 më datë 24.11.2018 ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokal, të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, me propozimin dhe aprovimin e tyre anëtar i komisionit nga fshati Mrasor u emërua z.Kujtim Rexhepi.

Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Banorët e fshatit Mrasor , me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje gjithsej 5 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Mrasor ishin si në vijim:

1. Endrit Mrasori
2. Driton Mrasori
3. Gëzim Mrasori
4. Isuf Mrasori
5. Kujtim Rexhepi.

Banorët e fshatit Mrasor me aklamacion (votim të hapur) u pajtuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje këta pesë anëtarë, duke vazhduar më pastaj me propozimet për kryetar këshilli të fshatit.

Të propozuarit për kryetarin e këshillit të fshatit Mrasor ishin si në vijim:

z.Lutfi Mrasori propozoi : z. Kujtim Rexhepi

Pasi që nuk kishte propozime të tjera nga banorët e fshatit, z.Rexhep Oruqi e qiti në votim të hapur propozimin e z. Lutfi Mrasori.

Me aklamacion(votim të hapur) z.Kujtim Rexhepi u zgjodh kryetar i këshillit të fshatit Mrasor.

z.Rexhep Oruqi konstatoi të mbyllur takimin dhe kryetarit të ri bashkë me këshillin ju uroi punë të palodhshme dhe shumë suksese e përfaqësim sa më dinjitoz në interes të banorëve të këtij lokaliteti.

FSHATI GEXHË

Më datë: 26.11.2018 me fillim në orën 17:00 u mbajt takimi me banorët e këtij fshati për zgjedhjen e këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Gexhë.

Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, me propozimin dhe aprovimin e tyre anëtar i komisionit nga fshati Gexhë u emërua z. Nexhmedin Krasniqi.

Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Banorët e fshatit Gexhë , me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë 3 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Gexhë ishin si në vijim:

1. Leutrim Himaj
2. Zyber Himaj]
3. Nexhmedin Krasniqi.

Banorët e fshatit Gexhë , me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje këta 3 anëtarë.

Të propozuarit për kryetarin e këshillit të fshatit Gexhë ishin si në vijim:

z.Milaim Morina propozoi : z. Leutrim Himaj.

Pasi që nuk kishte propozime të tjera nga banorët e fshatit, z.Rexhep Oruqi e qiti në votim të hapur propozimin e z. Milaim Morina.

Me aklamacion(votim të hapur) me gjithsej 17 vota z. Leutrim Himaj u zgjodh kryetar i këshillit të fshatit Gexhë.

Rexhep Oruqi konstatoi të mbyllur takimin dhe kryetarit të ri bashkë me këshillin ju uroi punë të palodhshme dhe shumë suksese e përfaqësim sa më dinjitoz në interes të banorëve të këtij lokaliteti.

FSHATI MALËSI E VOGËL

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Malësi e Vogël filloi në orën 18:30 më datë 26.11.2018 ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokal, të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, me propozimin dhe aprovimin e tyre anëtar i komisionit nga fshati Malësi e Vogël u emërua z.Smajl Zena.

Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Banorët e fshatit Mrasor , me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje gjithsej 7 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Malësi e Vogël ishin si në vijim:

1. Enver Çadraku
2. Bejtullah Kastrati
3. Azem Lushi
4. Smajl Zena
5. Safet Ukaj
6. Ramiz Morina
7. Can Kastrati.

Banorët e fshatit Malësi e Vogël , me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje këta 7 anëtarë.

Të propozuarit për kryetarin e këshillit të fshatit Malësi e Vogël ishin si në vijim:

z.Safet Ukaj propozoi : z. Enver Çadraku.

Pasi që nuk kishte propozime të tjera nga banorët e fshatit, z.Rexhep Oruqi e qiti në votim të hapur propozimin e z. Safet Ukaj.

Me aklamacion(votim të hapur) z. Enver Çadraku u zgjodh kryetar i këshillit të fshatit Malësi e Vogël.

Rexhep Oruqi konstatoi të mbyllur takimin dhe kryetarit të ri bashkë me këshillin ju uroi punë të palodhshme dhe shumë suksese.

FSHATI RATKOC

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Ratkoc filloi në orën 18:00 më datë 27.11.2018 ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokal, të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, me propozimin dhe aprovimin e tyre anëtar i komisionit nga fshati Ratkoc u emërua z.Bekim Krasniqi.

Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Banorët e fshatit Ratkoc me aklamacion (votim të hapur) u pajtuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje këta shtatë anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Ratkoc ishin si në vijim:

1. Beqë Shala
2. Dervish Morina
3. Jemin Hoti
4. Qëndrim Hoti
5. Samire Hoti
6. Afrim Hoti
7. Diana Hoti.

Banorët e fshatit Ratkoc me aklamacion (votim të hapur) u pajtuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje këta shtatë anëtarë, duke vazhduar më pastaj me propozimet për kryetar këshilli të fshatit.

Të propozuarit për kryetarin e këshillit të fshatit Ratkoc ishin si në vijim:

1. Beqë Shala
2. Jemin Hoti
3. Dervish Morina.

Pasi që ishin dy të propozuar z. Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit informoi të pranishmit për procedurat e votimit të fshehtë duke hapur kështu edhe procesin e votimit për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit.

Gjithsej votues:

Fletëvotime të vlefshme:364

Fletëvotime të pavlefshme:1

Beqë Shala mori gjithsej: 226 vota

Jemin Hoti mori gjithsej: 54 vota.

Dervish Morina mori gjithsej: 85 vota.

Me 226 vota gjithsej z.Beqë Shala u zgjodh kryetar i këshillit të fshatit Ratkoc.

z.Rexhep Oruqi konstatoi të mbyllur takimin dhe kryetarit të ri të këshillit të fshatit Ratkoc i uroi suksese dhe mbarësi në punë.

FSHATI DOBIDOL

Më datë: 29.11.2018 me fillim në orën 17:00 u mbajt takimi me banorët e këtij fshati për zgjedhjen e këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Dobidol.

Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, me propozimin dhe aprovimin e tyre anëtar i komisionit nga fshati Dobidol u emërua z.Lekë Gashi.

Rexhep Oruqi Kryesues i Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Banorët e fshatit Dobidol , me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë 5 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Dobidol ishin si në vijim:

1. Kujtim Sopjani
2. Lekë Gashi
3. Besim Morina
4. Kadri Rudi
5. Ukë Morina.

Banorët e fshatit Dobidol me aklamacion (votim të hapur) u pajtuan që këshilli i fshatit të ketë në përbërje këta pesë anëtarë, duke vazhduar më pastaj me propozimet për kryetar këshilli të fshatit.

Të propozuarit për kryetarin e këshillit të fshatit Dobidol ishin si në vijim:

z.Muharrem Krasniqi propozoi : z. Kujtim Sopjani.

Pasi që nuk kishte propozime të tjera nga banorët e fshatit, z.Rexhep Oruqi e qiti në votim të hapur propozimin e z. Muharrem Krasniqi.

Me aklamacion(votim të hapur) z. Kujtim Sopjani u zgjodh kryetar i këshillit të fshatit Dobidol.

Rexhep Oruqi konstatoi të mbyllur takimin dhe kryetarit të ri bashkë me këshillin ju uroi punë të palodhshme dhe shumë suksese.

FSHATI DEJNË

Më datë: 29.11.2018 me fillim në orën 18:30 u mbajt takimi me banorët e këtij fshati për zgjedhjen e këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Dejnë.

Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, me propozimin dhe aprovimin e tyre anëtar i komisionit nga fshati Dejnë u emërua z.Muhamet Morina.

